

REAGIMI QYTETAR NDAJ PREMTIMEVE ELEKTORALE DHE PROGRAMEVE QEVERISËSE

CITIZEN RESPONSE
TO ELECTORAL
PROMISES
AND POLITICAL
PROGRAMS



Reagimi qytetar ndaj premtimeve elektorale dhe programeve qeverisëse

Citizen response to electoral promises and political programs

QENDRA ALTAX

Analizë

Korrik 2021

ALTAX

Dokumente Politike e Fiskale

Nr.2021/07/05

www.altax.al

Datë 12.07.2021

Tiranë, Shqipëri

Deklarimi përgjegjësishë/ Disclaimer

Analiza është realizuar si pjesë e projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017” të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e kësaj analize mund të përdoret lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Qendrës AL-TAX” si burim informacioni.



Përmbledhje

Në zgjedhjet për Kuvendin në periudhën 2009 -2021 ka ulje të numrit të pjesëmarrjes së qytetarëve në votime. Ndërkohë, votuesit për partinë e majtë kanë rritje, e cila duket se vjen në një nivel konsistent, votuesit për partinë e djathtë paraqiten me ulje-ngritje dhe mungesë konsistence. Në këtë model sistemi politik, partitë e vogla shihen si valvola sigurie për dy partitë e mëdha, duke mundësuar mbijetesën e tyre, pa lënë mundësi dhe burime që ato të konkurojnë partitë e mëdha.

Partitë politike në Shqipëri (veçanërisht partitë e mëdha) nuk janë analizuar e gjykuar me votë në tërësinë e tyre për rishikimin e përgjegjësisë që drejtim të mosmbajtjes së premtimeve apo devijimit nga premtimet kur drejtojnë qeverinë. Arsyeja kryesore gjendet pikërisht te sistemi politik dypartiak, në një model demokracie të brishtë, ku kontrolli dhe balancat e pushtetit janë të dobëta. Një arsye tjetër, që ka diktuar këtë qasje gjendet edhe te faktorë të tjerë që merren në konsideratë nga votuesit e pavendosur dhe ata klientelistë, të cilët nuk e kushtëzojnë votën e tyre me informacionin ekonomik.

Nga perspektiva e arsytimit për votuesin e pavendosur, mekanizmi i llogaridhënies nuk ka funksionuar dhe është më keq sesa ishte më parë. Kjo gjetje shihet në uljen e numrit të votuesve në përgjithësi nga njëra zgjedhje në tjetrën.

Për partitë e sotme, të gjithë votuesit e synuar janë pikërisht këto dy kategori, që mbështesin një parti duke u nisur nga qasje personale dhe jo ajo ideologjike. Por, gjithashtu këto kategori përbëjnë edhe rrisht me të madh nëse mandati qeverisës nuk është konsumuar ashtu si është premtuar, pasi ata mund t'i kërkojnë llogari qeverisë me zë më të fortë se kategoria e votuesve ideologjikë.

Ndërsa partitë janë në opozitë kanë tendencën të rritin sasinë e premtimeve për politika tatimore zbutëse dhe angazhime politikash për grupe interesi specifike (pronarët e tokave, ushtarakët, minatorët, etj). Ndërsa partitë fitojnë mandatin për të qeverisur, premtimet elektorale janë të natyrës buxhetore, por pa harruar të përmendin si vijimësi të politikave tatimore, shtim buxhetesh për sektorët, por në fakt janë vetëm për efekt konkurrence elektorale.

Premtimet zgjedhore nuk janë bërë ende edhe sot një objekt i plotë analize dhe debati për ti konsideruar mirëfilli, si angazhime themeltare në programet e partive për të kryer politika të caktuara dhe për të arritur qëllime të caktuara. Por, aktivizimi i shoqërisë civile me një rol analize dhe ekspertize në rritje në dekadën e fundit duket se ka ndihmuar në formimin e kapitalit shoqëror dhe politik dhe advokimin e problematikave dhe çështjeve të diskutueshme dhe që kanë nevojë për informacion të vazhdueshëm të shoqëruar me analiza.

Motoja e ardhme e shoqërisë civile munde të ishte *“Një elektorat i mirë informuar dhe i mobilizuar politikisht ka më shumë rëndësi se niveli i zhvillimit ekonomik për të siguruar një qeverisje të mirë”*.

Abstract

In the last political elections for the Assembly in the period 2009-2021, there is a decrease in the number of citizens participating in the elections. Meanwhile, voters for the left party have an increase, which seems to come at a consistent level, voters for the right party appear with ups and downs and lack of consistency. In this model of political system, small parties are safety valves for the two big parties, enabling their survival, leaving no opportunities and resources for them to compete with the big parties.

Political parties in Albania (especially big parties) have not been analyzed and judged by vote in their entirety to review the responsibility towards non-fulfillment of promises or deviation from promises when running the government. The main reason lies precisely in the bipartisan political system, in a fragile model of democracy, where control and balances of power are weak. Another reason that has dictated this approach is found in other factors that are considered by undecided voters and clientelist voters, who do not condition their vote with economic information.

From the perspective of reasoning for the undecided voter, the accountability mechanism has not worked and is worse than it used to be. This finding is seen in the decrease in the number of voters in general from one election to another.

For today's parties, all targeted voters are precisely these two categories (undecided and clientelist voters), which support a party based on a personal approach and not an ideological one. But these categories also pose the greatest risk if the governing mandate is not consumed as promised, as they can hold the government accountable louder than the category of ideological voters.

Electoral promises have not yet become a full object of analysis and debate to be considered as genuine commitments in party programs to carry out certain policies and achieve certain goals. But the activation of civil society with a growing role of analysis and expertise in the last decade seems to have helped shape social and political capital and advocate for controversial issues that need ongoing information accompanied by analysis.

The future motto of civil society could be *"A well-informed and politically mobilized electorate is more important than the level of economic development to ensure good governance"*.

Hyrje

Ekziston një perceptim i gjerë se projektet e sotme për të ndihmuar njerëzit e zakonshëm janë një gjë e së kaluarës. Shumë qytetarë shprehen se e kanë humbur besimin tek qeverisja dhe besojnë se ajo është me një nivel jo të pranueshëm të përmbushjes së premtimeve elektorale.

Përvoja dhe ndërveprimet me institucionet e qeverisë duket se ndikojnë në perceptimet aktuale rreth performancës së saj. Për shkak se për ta është e vështirë të arrijnë te krijojnë komunikimin qytetar me zyrtarët kryesorë të qeverisë qendrore, qëndrimet e qytetarëve janë më së shumti një funksion ndërveprimesh me zyrtarët lokalë dhe nivelet e ulëta jo vendimmarrëse të institucioneve qendrore.

Në këtë ambient ku institucionet publike kanë arritur të hapen elektronikisht, por pa arritur të perceptohen si një hapje që mundëson adresimin final të zgjidhjes së kërkesave të tyre, qytetarët e shohin momentin e votimit si mundësinë kryesore për t'u afruar me qeveritarët, sepse është një nga veprimet e pakta që inkurajohet dhe është sanksionuar *de facto* nga qeveria. Ndërkohë, që arsyeja thelbësore dhe në interes direkt të qytetarëve është pikërisht njohja dhe komunikimi direkt me zyrtarët për adresimin e kërkesave të tyre, qytetarët përmendin në mënyrë të përsëritur se ata e motivojnë votën preferenciale si (a) përgjegjësi qytetare, (b) mundësi për të arritur ndryshimin, (d) rregull i demokracisë liberale për të ecur përpara nëpërmjet stimulimit të konkurrencës programore, dhe (e) për të ndëshkuar udhëheqësit.

Megjithëse kemi një kuptim të mirë të arsyes së përbashkët që qytetarët verbalizojnë për votimin, ka të ngjarë që të ketë motivime themelore që njerëzit nuk janë në gjendje t'i kuptojnë ose artikulojnë me vetëdije. Në zbrëthim të kësaj qasje të njerëzve në sistemin politik dhe social aktual, ne do të përpiqemi të japim argumentet tona për të shtjelluar dhe përcjellë më tej arsyet dhe logjikën ekonomike dhe politike.

Përgjegjësia në sistemin politik me dy parti mund të vërehet duke përdorur një model të thjeshtë nga zgjedhjet politike në Shqipëri. Në fakt, në një zgjedhje politike me një raund të vetëm, ku partitë garojnë në dimensionet ideologjike të majtë dhe të djathtë, teorikisht partia që pozicionon politikën e saj më të afërta me votuesin mesatar (ne vijim votuesi i pavendosur) do të fitojë. Partia fituese do të ketë një mandat ligjor politik për të zbatuar politikën e saj në qeverinë e ardhshme. Sidoqoftë, përgjegjësia politike përfshin një gjykim retrospektiv në lidhje me atë që partitë kanë bërë më parë në detyrë. Prandaj, është e nevojshme të përfshihet një element retrospektiv edhe në gjykimin e njerëzve. Kjo mund të realizohet duke bërë një analizë para dhe pas zgjedhore në pozicionin e politikës së qeverisë.

Një analizë e tillë është plotësisht e realizueshme nën sistemin aktual politik, sepse lehtëson kuptimin real të “qeverisë së fortë”. Kjo është, një qeveri që mund të përdorë statusin e saj të shumicës për të marrë kontrollin e plotë të agjendës legjislativë, me pak gjasa për t'u shqetësuar për pasojat e mundshme deri në zgjedhjet vijuese, të cilat mund të jenë vite larg.

Introduction

There is a sense that projects to help ordinary people are a thing of the past. Many citizens say they have lost faith in the government and believe that it has an unacceptable level of fulfillment of electoral promises.

Experience and interactions with the government also influence current perceptions of its performance. Because it is difficult to reach national government officials, citizen attitudes are most likely a function of interactions with local officials and low levels of central institutions.

In this political environment where public institutions have managed to open electronically, but without being perceived as an opening that enables the final addressing of the solution of their demands, citizens see the voting moment as the main opportunity to get closer to the government, because it is one of the few actions that is encouraged and de facto sanctioned by the government.

Citizens see voting as the main opportunity to engage with the government because it is one of few actions that is encouraged and officially sanctioned by the government. Citizens repeatedly mentioned several motivations for voting in elections, but mostly they motivate the vote as (a) responsibility, (b) possibility to achieve change, (d) as a rule of liberal democracy to go ahead, and (e) to punish bad leaders.

Although we have a good sense of the common reasons citizens verbalize for voting, there are likely underlying motivations that people are not able to consciously observe or articulate. For example, social pressure from communities and networks plays a significant role in driving the decision to vote, especially among poorer citizens.

Accountability in two-party political system can be explored using a simple model from elections of 2021. As a matter of fact, in a political election with a single round where the parties compete on a left-right ideological dimension, theoretically the party that positions its policies closest to the median voter will win. The winning party will possess a political legal mandate to implement its policies in future government. However, political accountability entails a retrospective judgment about what parties have previously done in office. Therefore, it is necessary to incorporate a retrospective element also into the people judgment. That can be done by introducing a pre- and post-election analysis in the government's policy position.

Such analysis is entirely feasible under actual political system, because facilitate real understanding of 'strong government'. That is, a government that can use its majority status to take full control of the legislative agenda, less likely to worry about possible repercussions until the following election, which may be years away.

Votuesit dhe besueshmëria në sistemin tonë politik

Performanca e sistemit politik varet më shumë nga mënyra në të cilën lidhja midis votuesve dhe politikanëve është strukturuar ose institucionalizuar sipas kuadrit kushtetues në fuqi. Sidoqoftë, ne nuk do të analizojmë shkallën që politikanët dhe votuesit janë të lidhur nga marrëdhëniet klienteliste ose ndonjë lloj tjetër i marrëdhënieve të ngjashme. Por do të trajtojmë pikërisht se si lidhet ambjenti ekonomik dhe politik me premtimet politike dhe programet qeverisëse bazuar mbi to.

Le të supozojmë, se në sistemin politik me dominim elektoral dy-partiak, ku merr mandatin e qeverisjes partia apo koalicioni që fiton me shumicë të thjeshtë, votuesit përballen me një zgjedhje midis partisë në pushtet, (me prirje të majtë) dhe partisë së opozitës, (me prirje të djathtë). Më tej supozojmë se p.sh. partia me prirje të majtë i fitoi zgjedhjet e mëparshme duke premtuar të zbatonte politikën ekonomike dhe politike në mandatin tjetër politik, nëse do të fitonte votën popullore.

Por, në momentin që merr mandatin politik për të qeverisur, ajo zbaton ndryshime të politikave në modelin ekonomik të pa përfshira në premtimet politike, si dhe një qasje pak e ndeshur në pozicionin politik të majtë. Nëse partia fituese do të kishte qëndruar në pozicionin e mëparshëm të premtimeve për qasjen ekonomike, ajo do të kishte si rregull një distancë të barabartë nga votuesi i pavendosur me partinë me prirje të djathtë, e cila është pozicionuar në një model ekonomik të pandryshuar në tre raundet e zgjedhjeve politike të dekadës së fundit. Sidoqoftë, partia me prirje të majtë e bën veten më elektorale dhe më pak konkurruese, duke supozuar se ajo nuk do të mbetet në pozitën e një programi ekonomik të pa përmbushur deri në zgjedhjet vijuese. Në rast të kundërt, votuesi i pavendosur mund të kërkojë llogari nga partia me prirje të majtë, por duke orientuar votën për partinë me prirje të djathtë.

Votuesit në nivel kombëtar për dy partitë e mëdha, 2009 -2021

Votat për PS dhe PD	PD dhe PS			
	2009	2013	2017	2021
Pjesëmarrja në votime	41%	36%	37%	38%
Partitë e tjera dhe mospjesëmarrje	59%	64%	63%	62%

Nga perspektiva e arsytimit për votuesin e pavendosur, mekanizmi i llogaridhënies nuk ka funksionuar dhe është më keq sesa ishte më parë. Kjo gjetje shihet në uljen e numrit të votuesve në

përgjithësi nga njëra zgjedhje në tjetrën¹. Nëpërmjet të dhënave në tabelë shihet se besueshmëria në dy partitë e mëdha së bashku ka rënie, duke marrë shkas në mungesën e një llogaridhënie sipas kërkesave të votuesve dhe mungesën e një dialogu të sinqertë mbi nevojat reale dhe zbatimi i programeve politike sipas një qasje bazuar te kërkesat që dalin nga konteksti elektoral dhe produktiviteti fiskal i buxhetit të vendit.

Megjithatë, ashtu si shihet edhe në tabelën tjetër, humbja e besimit të publikut duket se nuk është e lidhur domosdoshmërisht me ecurinë e buxhetit dhe financat publike.

¹ <http://ndiqparate.al/2021/04/30/rezultate-zgjedhore-ndarja-e-mandateve-per-deputet-procese-2021-2017-2013-dhe-2009/>

Premtimet buxhetore - fiskale dhe rezultatet zgjedhore, 2009-2021

PREMTIMET FISKALE DHE REZULTATET ZGJEDHORE	PD				PS				LSI			
	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021
Ulje/Heqje Taksash	1%	4%	15%	12%	4%	9%	8%	8%	10%	10%	46%	18%
Shtim shpenzimesh buxhetore	54%	41%	35%	17%	21%	23%	44%	23%	34%	34%	22%	12%
<i>Rezultatet zgjedhore*</i>	<i>40.2%</i>	<i>30.6%</i>	<i>28.9%</i>	<i>39.5%</i>	<i>40.9%</i>	<i>41.4%</i>	<i>48.3%</i>	<i>48.7%</i>	<i>10.5%</i>	<i>10.5%</i>	<i>14.3%</i>	<i>6.8%</i>

* <http://ndiqparate.al/2021/04/30/rezultate-zgjedhore-ndarja-e-mandateve-per-deputet-procese-2021-2017-2013-dhe-2009/>

Nëse do të llogaritim që fatin e fitores në zgjedhje nuk e vendos fokusimi te kjo kategori votuesi, por në një betejë zgjedhore faktorët ndikuesë janë të lidhur me një gamë më të gjerë elementësh, atëherë analizimi me përmbajtje gjithëpërfshirëse do të jetë edhe metodologjia e analizës për të arritur në përfundimin e kërkuar.

Në tabelën më lart, shihet se edhe pse premtimet për shtim buxheti për sektorët ekonomikë janë më të shumtë në zgjedhjet politike të vitit 2009 dhe 2013, duket se ato nuk përkojnë me një rritje të rezultatit zgjedhor për Partinë Demokratike në këto zgjedhje. Po kështu edhe për PS vlen të përmendet i njëjti fakt lidhur me premtimet në vitin 2013 dhe 2021, ku rezultatet zgjedhore janë më të larta se zgjedhjet e kaluara, por me premtime të ulura të shtimit të financimeve buxhetore.

Nën supozimet e bazuara te faktet e votimeve të dekadës së fundit², me gjithë ndryshimet e politikave ekonomike dhe mosmbajtjen e premtimeve të transformuara pjesërisht në programe qeverisëse³, vota popullore është orientuar e ndikuar në mënyrë të moderuar nga niveli i mbajtjes së premtimeve dhe përmbushjes së programeve të qeverisjes.

Kjo bazë krahasimi orienton analizën, se janë edhe faktorë të tjerë që merren në konsideratë nga votuesit e pavendosur dhe ata klientelistë, të cilët nuk e kushtëzojnë votën e tyre me informacionin ekonomik. Një qasje në këtë këndvështrim është se mungon analiza financiare e premtimeve buxhetore, për të treguar vërtetësinë e realizimit të tyre në rastin e programimit sipas buxhetit. Nga ana tjetër, në perceptimin e tyre këto premtime janë një përsëritje nga zgjedhjet e kaluara duke e humbur shpresën për përmbushje të tyre kohë më parë, por duke fokusuar kërkesat sipas grupeve të interesit dhe jo në nivel të komunitetit të gjerë.

Votuesit në nivel kombëtar për PS dhe PD, 2009 -2021

Votat për PS dhe PD	PD				PS			
	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021
Pjesëmarrja në votime	21%	16%	14%	18%	21%	20%	23%	20%

Nëse votuesi i pavendosur do të mbështeste logjikën për orientimin e votës së tij, sipas programeve politike dhe ekonomike, si dhe nga qasja e fakteve retrospektive të qeverisjeve të

² <http://ndiqparate.al/2021/03/16/rezultate-zgjedhore-ndarja-e-mandateve-per-deputet-procese-2009-2013-dhe-2017/>

³ <https://polifakt.al/wp-content/uploads/2021/03/PERGJEGJSHMERIA-FINANCIARE-E-PREMTIMEVE-TE-POLITIKES-SHQIPTARE-2009-2017.pdf>

kaluara, atëherë vota që do të përcaktonte fitoren duhet të dilte pikërisht nga kjo kategori votuesi. Argumenti bindës për të mos votuar partinë që ka ndryshuar modelin e politikave ekonomike, si dhe që nuk ka realizuar mbi mesataren programet në periudhën e qeverisjes do të ishte i mjaftueshëm. Por, ky konstatim duket se kundërshtohet nga treguesit e votimit për secilën parti në raport me nivelin e numrit gjithsej të qytetarëve me të drejtë vote.

Kështu, edhe pse programet politike të qeverisë Rama 1 dhe Rama 2 kanë një dinamikë që prek sektorë jetikë për interesat e një komuniteti sa më të gjerë të mundshëm duket se nuk ka një ndikim rritës me më shumë se 1-2 pikë përqindje (shih tabelën më lart). Në rastin e zgjedhjeve të vitit 2017 diferenca në rritjen e numrit të votuesve është më së shumti një vendimarrje e ndikuar nga votuesi i pavendosur, i cili përfshin kategorinë e votuesve që nisen nga qasja politike programore, se sa nga programe të mirëfillta ekonomike. Në fushatën zgjedhore të vitit 2017, PS pati një vijimësi të programeve të filluara në vitin 2013, por jo programe ekonomike që ndryshonin nga zgjedhjet e kaluara dhe të përbënin dallimin në filozofinë e modelimit të ri ekonomik.

Në këtë drejtim, tendenca e premtimeve dhe propagandës elektorale drejt arritjes të votuesit të pavendosur vijnë me një vëmendje të shtuar nga zgjedhja në zgjedhje.

Analiza jonë deri më tani ka supozuar se vetëm votuesi i pavendosur ka rëndësi të konsiderueshme për sa i përket përgjegjësisë. Votuesi i pavendosur normalisht është në qendër të vëmendjes në sistemin dy partiak, sepse mbështetja e tij është e nevojshme që një parti të arrijë fitoren.

Sidoqoftë, kjo mbështetje nuk është e mjaftueshme. Një parti, në mënyrë që të marrë shumicën duhet të synojë gjithashtu mbështetjen e votuesve klientelistë, që nuk e lidhin orientimin e votës së tyre tek qasja ideologjike, por më së shumti te përmbushjet e ambicieve personale/familjare (qasje bazuar te materializmi⁴).

Për partitë e sotme, votuesit e synuar janë pikërisht këto dy kategori, që mbështesin një parti duke u nisur nga qasje personale dhe jo ajo ideologjike. Por, gjithashtu këto kategori përbëjnë edhe rrishtin më të madh nëse mandati qeverisës nuk është konsumuar ashtu si është premtuar, pasi ata mund t'i kërkojnë llogari qeverisë me zë më të fortë se kategoria e votuesve ideologjikë.

Ndërkohë kategoria e votuesit ideologjik, i cili ka argument logjik për orientimin e votës së tij kryesisht nostalgjinë politiko-ekonomike e sociale të ideologjisë, që përkon me orientimin ideologjik të partisë, që i mbart teorikisht këto prirje në periudhën aktuale është një faktor me ndikim në rezultatet zgjedhore të dekadës së fundit⁵.

⁴ një prirje për të konsideruar zotërimin material dhe komoditetin fizik si më të rëndësishëm se vlerat shpirtërore

⁵ <http://ndiqparate.al/2021/04/29/lista-e-zgjedhesve-ne-vite-pjesemarrja-dhe-vlefshmeria-e-votes-2015-2021/>

<https://www.osce.org/files/f/documents/e/f/38598.pdf>

<https://www.osce.org/files/f/documents/9/0/108194.pdf>

Gjatë periudhës së fundit 30 vjeçare të sistemit politik, dy partitë që kanë prirje ideologjike të kundërta me njëra-tjetrën kanë devijuar deri në braktisje pozicionet e tyre të mëparshëm të politikës dhe janë zhvendosur më djathtas (partia me prirje të majtë), si dhe më majtas (partia me prirje të djathtë) duke patur pika konvergimi me njëra-tjetrën lidhur me premtimet për ekonominë, politika sociale, politika për shtresat e caktuara, si dhe premtimet e politikave sektoriale.


Në tabelën më poshtë vërehet, se ndërsa partia e djathtë ka një pakësim të numrit të votuesve për të deri në zgjedhjet e 2021, partitë e majta kanë një shtim të numrit të votuesve duke arritur në konstatimin se numri i votuesve të pavendosur dhe votuesve klientelistë janë dy kategoritë që kanë qenë fokusi për secilën nga partitë, por pa arritur të realizojnë njësoj objektivin e tyre.

Numri votuesve sipas partive kryesore dhe rezultatet zgjedhore, 2009-2021

ZGJEDHESIT SIPAS FUSHATAVE ZGJEDHORE	PD				PS				LSI			
	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021
Numri votuesve	610,463	528,373	456,413	622,187	620,586	713,407	764,750	768,134	73,678	180,470	225,901	107,538
Rezultatet zgjedhore	40.2%	30.6%	28.9%	39.5%	40.9%	41.4%	48.3%	48.7%	10.5%	10.5%	14.3%	6.8%

Në analizën e realizimit të objektivave zgjedhore për maksimalizim të votave në të dyja kategoritë, në grafikun më poshtë vërehet pikërisht se ndërsa partitë janë në opozitë kanë tendencën të rritin sasinë e premtimeve për politika tatimore zbutëse dhe angazhime politikash për grupe interesi specifike (pronarët e tokave, ushtarakët, minatorët, etj.). Ndërsa partitë fitojnë mandatin për të qeverisur, premtimet elektorale janë të natyrës buxhetore, por pa harruar të përmendin si vijimësi të politikave tatimore, shtim buxhetesh për sektorët, por në fakt janë vetëm për efekt konkurrence elektorale.

Tendenca premtimeve (PS vs. PD), 2009-2021




Kjo shikohet nëse vërejmë se premtimet nuk arrijnë të realizohen në rastin më të mirë më shumë se sa gjysma e tyre.

http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/syri_vezhguesit/Raporti%20i%20OSBE-ODIHR%20shqip.pdf?ver=2018-05-04-133953-700

<http://kqz.gov.al/results/results2021/results2021.htm>

Në qeverisjen Berisha 1 (në koalicion me LSI dhe parti të tjera), niveli i realizimit të premtimeve është 20% deri në mbylljen e mandatit qeverisës në vitin 2013.



Në qeverisjen Rama 1, niveli i realizimit të premtimeve është 36% (në koalicion me LSI dhe parti të tjera), ndërsa në qeverisjen Rama 2 (PS e vetme në qeverisje), niveli i realizimit të premtimeve është 52%. Në dukje shihet se niveli i realizimit të programeve qeverisëse të bazuara në premtimet elektorale

është në rritje, por në fakt edhe në rastin kur kemi të bëjmë me një parti të vetme në qeverisje ky nivel është i ulët. Arsyeja e një niveli të ulët realizimi vijnë sa nga orientimi i premtimeve drejt dëshirave të kategorive të votuesve të pavendosur dhe klientelistë, por edhe një maturim ende i paplotë i modelit politik që zbatohet sipas sistemit që partitë e mëdha kanë preferuar të zbatohet në gjithë këto vite.

Në tërësinë e tyre, të dy kategoritë e votuesve edhe pse kanë bërë zgjedhjet e tyre të ndikuara edhe nga politika, ata nuk kanë rritur dobinë e zgjedhjes në funksion të leverdisë ekonomike edhe pse politika është zhvendosur në pozicione ideologjike më larg pikës së tyre ideale. Në të njëjtën distancë, që ato janë zhvendosur nga ideologjia e tyre në momentin kur u (ri)krijuan, po aq duhej të ishte zhvendosur edhe votuesi ideologjik në raport me bindjet e tij fillestare. Nisur nga intensiteti i pjesëmarrjes së grup moshave mbi 60-65 vjeç në votime (një grup moshë me përvojë politike nga ideologjia me prirje të majtë dhe të djathtë), si dhe duke u bazuar te fakti i një mungese në tregun e botimeve politike të studimeve që mund të orientonin zhvendosjen ideologjike drejt të menduarit bazuar te modeli ekonomik dhe ekonomia mbi politikën ka ndodhur një ndryshim i vogël i zhvendosjes së prirjes politike të votuesve drejt qendrës apo partisë me prirje të djathtë.


Qasja më efektive, por jo e vetme e saj për ta bërë këtë do të ishte argumentimi i bazuar mbi informacion dhe analizën ekonomike dhe teknike të efektshmërisë së partive politike gjatë periudhës që kanë qeverisur (të vetme apo në koalicione).

Reagimi qytetar ndaj dështimit të përgjegjshmërisë


Në votimet e 12 viteve të fundit edhe pse me ngjashmëri në nivelin e abstenimit të votës (mos shkuarjes në votim), është vërejtur se një pjesë e mirë e votuesve nuk e kanë ushtruar të drejtën e tyre. Zakonisht, në zëvendësim të votës së tyre të munguar kanë qenë votuesit ideologjikë dhe ata që kanë qasje materialiste (votuesit klientelistë). Votuesit e pavendosur (përfshirë centristët)

kanë patur një anim më tepër nga abstenimi edhe të ndikuar prej perceptimit se pak dallim egziston midis partive, por që gjithsesi edhe pjesëmarrja e tyre ka patur rritje.


2009 General election




Turnout:
50.5%



2013 General election




Turnout:
53.5%




2017 General election




Turnout:
46.8%



2021 General election



Turnout:
46.29%




Në grafikën e pjesëmarrjes në zgjedhjet për Kuvendin në periudhën 2009 -2021 ka ulje të numrit të pjesëmarrjes së qytetarëve në votime. Ndërkohë, votuesit për partinë e majtë kanë rritje, e cila duket se vjen në një nivel konsistent, votuesit për partinë e djathtë paraqiten me ulje-ngritje dhe mungesë konsistence.

Kur dihet se partitë e mëdha e kanë polarizuar gjithnjë e më shumë qasjen e votimit, shikohet se votuesit ideologjikë janë më të motivuar për të votuar, ndërsa centristët kanë abstenuar, jo aq për shkak të indiferencës, por për shkak të tjetërsimit të frymës së tyre politike nga i gjithë sistemi aktual politik.

Abstenimi është kryesisht i lidhur me votuesit e pavendosur dhe votuesit me qasje materialiste të pakënaqur/ pa oferta konkrete materiale. Kjo është ndërkohë edhe një reagim i tyre ndaj mungesës së përgjegjësisë nga partitë politike (pozita dhe opozita), sepse në mënyrë jo të vullnetshme i shtyn votuesit e pakënaqur të tërhiqen nga procesi demokratik. Për më tepër, nëse abstenimi do të ishte edhe nga ekstremistët e partisë që qeveris vendin, atëherë fitorja do të largohej në mënyrë disproporcionale nga ky krah ideologjik. Kjo mund ta bënte më të mundshme që partia në krahun e kundërt ideologjik (opozita) të fitonte zgjedhjet.


Sidoqoftë, abstenimi është një përgjigje ndaj zhgënjimit të votuesve me politikën dy-partiake, në rastin e zgjedhjeve politike në Shqipëri ky skenar që ne analizuam më lart si një reagim ndaj mungesës së përgjegjësisë së partisë qeverisëse nuk ndodh domosdoshmërisht në drejtimin e përshkruar.



Ky qëndrim mund të shikohet në votuesit për PD-në. Nga viti 2009 deri në vitin 2021, PD ka qeverisur në harkun kohor 2009-2013. Edhe pse në opozitë për 8 vite, opozita përsëri duket se nuk ka punuar mjaftueshëm për të arritur të forcojë pozitën në bastionet e saj, por edhe te pjesa e

votuesve të pavendosur në zonat ku konsiderohen bastione të majta, apo në kryeqytet ku shumica e votuesve janë të pavendosur.

Përveç sigurimit të qasjes populiste me një mundësi për të kapur pakënaqësinë në rritje lidhur me situatën ekonomike dhe nivelin e mirëqenies, korrupsionin (Shqipëria renditet ndër vendet më të korruptuara në Europë), zhvendosja politike e së djathtës shërbeu për të rritur epërsinë e ankesave sociale dhe ekonomike, por duke mos kaluar dot të arrijë të konvertojë në vota fitoreje votuesit e pavendosur. Ndërsa e majta dhe e djathta tentojnë të konvergojnë në çështjet e politikës ekonomike, politizimi i çështjeve joekonomike u bë tema që synuan të tërheqin votuesit. Por, PD, nuk arriti të depërtojë me analiza të thelluara dhe shteruese, si dhe me një vetëbindje irracionale se ndryshimi i tendencës së votës do të vinte për forcë rotacioni historik ciklik, i cili në 30 vitet e fundit ka ndodhur pas 8 viteve qeverisje të partisë së djathtë/të majtë arrit vetëm të marrë një pjesë modeste nga vota e të pavendosurve. Në fakt, në analizën e premtimeve elektorale të partisë së djathtë dhe të majtë shikohet se mungon konkurrenca e ideve në një fushë/çështje të re duke u paraqitur para votuesve me pak ose aspak dallime ideologjike/të dukshme nga njëri-tjetri. Kjo qasje strategjike elektorale e partisë së djathtë dhe të majtë nuk e kanë shmangur dot humbjen e votuesve si pasojë e indiferencës ndaj politikës. Këto dinamika gjithashtu nxitën parti/lëvizje të reja të shfaqen dhe të konkurrojnë në çështje jo-ekonomike, por polarizimi i madh i elektoratit dhe propaganda e shfrenuar deri në shkelje të Kodit (etikës) Zgjedhor⁶. Në mënyrë të ngjashme, me pak diferenca midis të majtës dhe të djathtës, duke u bazuar te një qasje tradicionale në mungesën e duhur të vëmendjes në çështjet e politikës ekonomike, votuesit gjetën arsye t'u kushtonin më shumë vëmendje faktorëve joekonomikë.



⁶ <https://polifakt.al/wp-content/uploads/2021/03/PERGJEGJSHMERIA-FINANCIARE-E-PREMTIMEVE-TE-POLITIKES-SHQIPTARE-2009-2017.pdf>

<https://altax.al/al/publikime-te-altax/product/besueshmeria-dhe-pergjegjshmeria-financiare-e-premtimeve-zgjedhore-te-politikes-shqiptare-ne-2021>

Ndërkohë, sipas Grafikut më lart një ndryshim i përkrahjes në votë vërehet për PS. Kjo parti e majtë, më e madhja në nivel votuesish në vend, ka qeverisur vendin nga viti 2013 – 2021, në analizën tonë. Në periudhën e qeverisjes së vendit ka rënie të votuesve në bastionet e saj (Berat, Fier, Gjirokastër), por rritje në zona ku janë me shumicë votuesit e pavendosur dhe votuesit klientelistë (Tiranë, Durrës, Elbasan).

Ne argumentojmë, se zhvendosja e së majtës në qendër për çështjet ekonomike, dhe në veçanti pranimi i saj i reformave "neoliberale" siç është privatizimi të pjesëve të sektorit publik, ulje të taksave dhe shtetit të mirëqenies kanë dhënë efektin e tyre në rritjen e përkrahjes nga votuesit e pavendosur. Megjithëse kjo zhvendosje ka një kuptim në periudhën afatshkurtër, për një periudhë afatgjatë mundet të ketë pasoja të dëmshme, ndoshta edhe fatale, pasi orientimi drejt votuesit të pavendosur dhe klientelist në kurriz të votuesit ideologjik ul profilin politik të partisë, por edhe vijimësinë e përkrahjes në zonat ku konsiderohen bastione politike. Zhvendosja në profilin politik të së djathtës, duket se u pasqyrua në humbjen e votave ideologjike në bastionet e saj (Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë). Për më tepër, kjo zhvendosje dhe pasojat e saj kanë qenë thelbësore për ngritjen e një të djathte nativiste, populiste dhe për tu identifikuar me zgjidhjen e problemeve më të gjera me të cilat përballet demokracia sot në vendin tonë.

Një arsye, ku skenari i abstenimit të votuesve nuk ka ndodhur në mënyrë masive është edhe prania e partive të vogla, të cilat u kanë ofruar votuesve mundësinë për të hedhur votat e protestës për këto parti.

Një rast shembull në këtë orientim është Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila është rritur deri në zgjedhjet e vitit 2021 kryesisht duke ruajtur një profil anti establishment edhe pse në dy qeverisjet (Berisha 2 dhe Rama 1) kanë qenë pjesë faktoriale e këtyre kabineteve. Votat e përfituara nga kjo parti janë pjesërisht vota kundër partisë qeverisëse, por ato janë edhe vota të votuesve të pavendosur dhe votuesve klientelistë, që tregojnë një mosgatishmëri për të votuar për partinë kryesore të opozitës.

Votuesit që mbështesin partitë e vogla (LSI, PR, PSD, PDIU, PAA, LZHK etj.) në mënyrë të efektshme abstenojnë nga zgjedhja si opsion votimi për qeverinë, sepse ata shikojnë te këto parti mundësinë që të fitojnë pozicione.

Nga një perspektivë, votimi për një parti të vogël, të papërfshirë në aleancë me partitë e mëdha për votuesin klientelist dhe votuesin e pavendosur perceptohet si një humbje kohe dhe konsum i pavlerë i votës së tyre. Ndërkohë, premtimet e një partie të madhe, që kanë shanse të mëdha të kthehen në programe pranohen më lehtësisht si oferta që i vlejnë një votuesi për një shërbim më të pritur se sa partia e vogël dhe kështu do të ishte racionale të votohet për partinë që e bën votuesin më të nxitur "të harxhojë" të drejtën e votës në emër/adresë të dikujt që duket pa shpresë.

Sidoqoftë, zgjedhjet janë ngjarje të përsëritura dhe votuesit mund të shikojnë jo vetëm nga e ardhmja por edhe nga e kaluara.

Një votues mund të presë përfitim më të lartë pas zgjedhjeve të ardhshme nga rizgjedhja e partisë në pushtet. Por nëse e njëjta parti ka thyer premtimet e saj pas zgjedhjeve të mëparshme, për votuesin ka më shumë kuptim ta ndëshkojë qeverinë. Votimi për të përsëri është shpërblyes pasi vota e tij jepet në përfitim të dënimit të shkeljes së premtimeve (mospërfshirje/ mospërmbushje programi) gjatë ushtrimit të mandatit qeverisës të partisë. Por, votimi për partinë e madhe të opozitës nuk i jep të njëjtin përfitim votuesit klientelist/pavendosur, pasi vlera e konvertimit të votës së tij është më pak e dobishme në krahasim me vlerën e pritshme që përfitohet me partinë e madhe fituese.

Por, në historikun e zgjedhjeve parlamentare vërehet një tendencë e futjes së klimës elektorale në procese informale/ekstraligjore, që ndër arsyt kryesore është të sigurojnë një perimetër garancie për votat e sigurta të mos jenë të kërcënuara nga partitë e vogla dhe ato të reja.

Një shembull që mund të përfshijmë në këtë argument është Këshilli Politik, i ngritur nga të dyja partitë e mëdha nga ku u vërejt se, partitë e mbështetura tek votat e protestës ndaj partitokracisë dhe politikës qeverisëse nuk arritën të lëvizin përtej statusit të partive të vogla, pasi ato nuk ja dolën të gëzojnë mbështetje të përqendruar gjeografikisht për shkak të vështirësisë së fitimit të votave të mjaftueshme për pragun elektorale, i miratuar nga konsensusi me bazë të ngushtë i dy partive të mëdha.

Edhe nivelet e konsiderueshme të mbështetjes elektorale të partive të vogla/reja rezultuan se nuk mund të funksionojnë më shumë se të jenë në funksion të mirëmbajtjes së një sistemi parlamentar kryesisht dy-partiak, por që nuk lejohen të jenë përtej këtij formati bllokues të sanksionuar edhe në Kodin Zgjedhor. Në këtë model sistemi politik, partitë e vogla shihen si valvola sigurie për dy partitë e mëdha, duke mundësuar mbijetesën e tyre, pa lënë mundësi dhe burime që ato të konkurojnë partitë e mëdha. Ky model politik funksional në këto tre dekada ka ndikuar që mbështetja për partitë e vogla të ketë rënë dhe rrjedha e votës ka qenë pasoja më e dukshme. Votimi për partitë e vogla është një reagim që tregon difektet e sistemit, por tregon edhe nevojën për informimin dhe edukimin e votuesit që të jenë të orientuar në votën e tyre ndaj dështimeve të llogaridhënies në sistemin dy-partiak, i cili bazohet pikërisht nga votat e votuesit klientelist dhe votuesit të pavendosur.

Ndërkohë, një ndikim të kufizuar në drejtim të përfaqësimit legjislativ të partive të vogla e jep ndarja/konvertimi i votës së partive të vogla të marrë në emër të kauzave dhe pakënaqësisë në drejtim të partive të mëdha, sipas një qasje materialiste njësoj si votuesi individual.

Kjo qasje e partive të vogla ka ndodhur me aleancat që ka bërë LSI në dy mandate qeverisës të kaluar, pa asnjë bosht ideologjik si motivim, apo edhe si argument për votuesin e pavendosur dhe atë klientelist.

Zhvendosja e boshtit kryesor të konkurrencës politike nga çështjet ekonomike në ato sociale në realitetin e fushatave elektorale në këto 12 vite të fundit ka qenë një përfitim më shumë për të djathtën populiste sesa për të majtën tradicionale. Kështu, premtimet për rritje pensioni, për

rritjen e pagës, për uljen e taksave dhe forcimin e politikave sociale kanë prodhuar vota më të mëdha në zonat rurale për PD dhe aleatët e saj. Historikisht, të paktën në periudhën që po analizojmë, e majta ka përfituar më shumë kur identiteti elektoral i saj është orientuar i përqëndruar drejt grupeve/shtresave të marginalizuara duke u prirur të jetë në simbiozë me pakënaqësinë e votuesit të majtë, i cili nuk identifikon si të keqen e vet partinë politike, por sistemin politik. Ky kamuflim strategjik i partisë së majtë nën ombrellën ideologjike duke synuar të zgjerojë bazën e votimit të partisë së majtë në larmishmërinë e saj (diversifikim të bazës) është më i dukshëm se baza e votuesve të së djathtës (për sa i përket etnisë, fesë dhe identitetit seksual). Natyrshëm, që nëpërmjet politikës së diversifikimit të bazës së votuesve është arritur edhe të ndahet orientimi politik midis një të majte "të re" dhe një të majte "të vjetër" që ka spikatur për normat shoqërore tradicionale, të trashëguara nga sistemi i kaluar. Pra, kur konkurrenca politike përqendrohet në çështje sociale, bëhet më e vështirë për partitë e majta të ndërtojnë dhe mbajnë koalicione të gjera, kohezive elektorale, ndërsa heqja dorë prej kësaj qasje elektorale politike prej partive të djathta ka rezultuar në mpakjen dhe mungesën e zgjerimit të bazës së votuesve, në një mënyrë të ngjashme si partia e majtë.

Përgjegjshmëria e partive politike si një ballafaqim me premtimet dhe programet politike dhe jo si një e keqe e nevojshme

Partitë politike në Shqipëri (veçanërisht partitë e mëdha) nuk janë analizuar e gjykuar me votë në tërësinë e tyre për rishikimin e përgjegjësisë që drejtim të mosmbajtjes së premtimeve apo devijimit nga premtimet kur drejtojnë qeverinë. Në shikim të parë, kjo formë e përgjegjësisë duket se ndodh në ditën e votimit duke ju nënshtuar hamendësimit se votuesi është i kujdesshëm të mbajë qëndrim për përgjegjësinë politike dhe qeverisëse të partive. Një marëdhënie në këtë format mundet të ndodh nëse performanca politike/qeverisëse konsiderohet nga votuesi e papranueshme dhe mbi këtë argument përcaktohet përgjegjësia dhe bëhet shkëmbimi i bindjes në votën në adresën e partisë që është në krahun e përgjegjshmërisë. Por, në analizën e katër zgjedhjeve parlamentare të fundit, qeveritë edhe pse kanë treguar se i kanë shkelur premtimet që duhet ti përmbushnin gjatë mandatit të tyre ose janë prezantuar si të paafta në ushtrimin e detyrës (drejtuesë institucionesh qendrore me kapacitete dhe integritet të cunguar), elektorati përsëri nuk i ka "pushuar", por i ka rivotuar në zgjedhjet e ardhshme.

Arsyeja kryesore gjendet pikërisht te sistemi politik dypartiak, në një model demokracie të brishtë, ku kontrolli dhe balancat e pushtetit janë të dobëta. Sistemet dy-partiake nuk mishërojnë strukturat e konkurrencës për qeverinë. Ato përfshijnë të njëjtat parti të alternuara në administrata me shumicë partiake. Strukturat partiake janë konkurrenca e pandershme e modelit të qeverisjes së hapur që zbatohet në vendet që aplikojnë me sukses një sistem demokratik liberal.

Në qeverisjet e bazuara te konkurrenca partiake, futen edhe partitë e vogla dhe të reja, që gëzojnë të drejtën për t'u bashkuar me partitë më të mëdha në qeveri, por me një përfshirje që kompromenton emrin e tyre të mirë dhe besimin e elektoratit që beson tek ato.

Sistemet e hapura gjithnjë kanë tendencë të jenë të natyrës shumë-partiake dhe të bazuara në teknokratë. Zgjedhja e përbërjes qeveritare në sistemet e hapura është më pak kufizuese sesa zgjedhja e një kabineti të detyruar në sistemin tonë dypartiak. Nëse votuesve nuk u pëlqen qeveria e një partie kryesore në koalicionin me bazë të gjerë, ata kanë ndikimin e duhur të përcjellin mesazhin për një qeveri të një partie tjetër. Në një parti të madhe të majtë, e cila qeveris me një shumicë parlamentare, nëse një pjesë e fortë e përkrahësve të saj janë të pakënaqur me performancën e saj, ata kanë mundësi të tronditin koalicionin qeverisës pasi sistemi mundëson opsione për të votuar parti më pranë mundësisë për të fituar dhe përfaqësuar ata në një koalicion pa partitë e mëdha. Ata mund të votojnë për partitë centriste të vogla duke qenë ndikuesë edhe në detyrimin e tyre për të formuar një koalicion qeverisës. Secili rezultat do të detyronte një ndryshim në politikën qeveritare.

Natyrshëm, që pikëpyetje të mëdha lindin edhe në këto zgjedhje në lidhje me përgjegjësinë dhe qeveritë e koalicionit, pasi ato nuk zgjidhen drejtpërdrejt nga votuesit, por formohen pas zgjedhjeve gjatë negociatave midis partive pjesëmarrëse në zgjedhje. Ky bashkim me bazë të gjerë bëhet problematik kur premtimet e zgjedhore tregtohen për të nënshkruar një marrëveshje koalicioni. Arsye të tjera që tregojnë problemet e koalicionit mund të ketë plot, por në rast se votuesit arrijnë të gjejnë fajtorin për mungesat e performancës qeverisëse, atëherë ndëshkimi për partinë fajtoresh është me pasoja për të ardhmen, pasi sistemi politik gjeneron në vijimësi parti të reja.

Nën optikën e krahasimit midis dy sistemeve politike shihet se në sistemin politik dy partiak ka një nivel të dobët të përgjegjshmërisë, për arsyen e thjeshtë se ekziston vetëm një mundësi alternative qeverisëse, pavarësisht anësisë ideologjike duke mbyllur mundësitë e konkurrencës dhe hapjes së qeverisë për publikun.

Një sistem i hapur partiak, i bazuar në konkurrimin e të mëdhenjve prej partive më të vogla që shikohen nga votuesit si ndikuese të forta në përgjegjshmërinë e qeverisjes, nisur nga nevoja e tyre për të konkuruar në tregun politik do t'u mundësonte votuesve të kërkonin llogari nga qeveria për ndryshimet/përmbushjet e politikave të saj. Nëse interesi i votuesve është i lidhur me rezultatet e politikave qeverisëse metoda e llogaridhënies nëpërmjet mbështetjes së partive të vogla/ të reja do të sigurojë më mirë ndryshimin e dëshiruar të politikës .

Versioni aktual i kërimit të llogarisë së përgjegjshësisë nëpërmjet votës në një ditë të caktuar në 4 vite nuk ka arritur të zbatohet me të njëjtën forcë për mbrojtjet e të drejtave të votuesve. Mbajtja e palëvizur e një grupi votuesish të pavendosur, ndikuesë dhe me rritje në periudha krizash është lidhja midis votës dhe rezultatit në sistemin dy-partiak. Kjo marëdhënie duhet të funksiononte si një raport i ndërtuar mbi llogaridhënien midis qytetarëve dhe elitave. Por, në realitetin e mekanizmave të funksionimit të politikës në Shqipëri ndryshimet reale të sistemit zgjedhor janë të rralla. Partitë e mëdha përfitojnë nga *status quo*-ja dhe janë ende në gjendje të bllokojnë propozimet për reformë, ashtu si mund të jetë konstatuar nga vetë votuesit. Herë pas here ato krijojnë instrumente politike ekstraligjore, që të manipulojnë votuesin me idenë e ndryshimeve,

të cilat në fakt ndodhin dhe miratohen në favor të ruajtjes së pozitive dominuese të tyre në tregun politik.

Përgjegjësia politike e partive të mëdha supozohet të jetë e vështirë për tu mbajtur për premtimet elektorale dhe programet politike në periudhën e qeverisjes. Për më tepër, ndërsa konkurrenca e partive është bërë gjithnjë e më bipolare në sistemet shumë partiakë, po ashtu edhe për votuesit është bërë më e vështirë të ndërrojnë mbështetjen midis partive të secilit bllok, si një mjet për ti bërë ato të përgjegjshme për mbajtjen e premtimeve, por edhe përmbushjen e programeve qeverisëse. Votuesit e pavendosur mund të kalojnë midis blloqeve politike, duke mundësuar përgjegjshmëri pjesore, por kjo nuk zgjidh ende ushtrimin e presionit të votës për të ndëshkuar përgjegjësitë dhe gabimet politike me kosto për të ardhmen dhe të tashmen. Megjithatë ne shtrojmë si një drejtim të domosdoshëm çështjen e diskutimit të përgjegjësisë si një orientim thelbësor për debatet rreth demokracisë.

A kanë ndonjë pasojë elektorale partitë qeveritare nga mosmbajtja e premtimeve?

A duhet që partitë qeveritare të kenë frikë nga humbje të zgjedhjeve politike, nëse shfaqin një performancë të dobët në përmbushjen e programeve të tyre?

Në fakt edhe Shqipëria nuk bën ndryshim nga lidhja e fortë midis mbajtjes së premtimeve dhe rizgjedhjes së tyre⁷. Një nga dilemat që konstatohet nga historiku i rezultateve zgjedhore në periudhën 2009-2021 është fakti, nëse qytetarët e konsiderojnë këtë ndryshim në performancë në zgjedhjen e partisë që ata votojnë?

Realizimi i premtimeve dhe rezultatet zgjedhore, 2009-2021

PREMTIMET DHE REZULTATET ZGJEDHORE*	PD				PS			
	2009-2013	2013	2017	2021	2009	2013-2017	2017-2021	2021
Niveli realizimit të premtimeve nga qeverisja	20%					36%	52%	
<i>Rezultatet zgjedhore</i>	<i>40.2%</i>	<i>30.6%</i>	<i>28.9%</i>	<i>39.5%</i>	<i>40.9%</i>	<i>41.4%</i>	<i>48.3%</i>	<i>48.7%</i>

* Ilogaritjet nga ALTAX

Duke e parë nga ky këndvështrim i analizës, nga tabela më poshtë shikojmë se mund të ketë pasoja të konsiderueshme në rizgjedhjen e partisë duke u nisur nga mbajtja/mosmbajtja e nivelit të performancës së premtimeve elektorale në programet politike të partisë kryesore qeverisëse. Kjo duket nga fakti i matur, se ndërsa niveli i mbajtjes së premtimeve nga partia e djathtë, si parti kryesore e koalicionit qeverisës ka rezultuar në një nivel mosmbajtje të lartë të deklaratave politike dhe programeve bazuar mbi deklaratat nuk është rizgjedhur dot. Ndërkohë, një performancë më e lartë e partisë së majtë në tregon se është një arsye për tu rivotuar dhe rizgjedhur për të qeverisur. Natyrisht, vetëm kjo nuk mjafton si arsye për të tërhequr votat e të pavendosurve, por është një faktor direkt dhe i matshëm për të orientuar argumentimin e një shansi për të fituar zgjedhjet politike.

⁷ shih te Aneksi "Performana buxhetore, ekonomike dhe sociale e premtimeve dhe programeve politike 2009-2021

Performanca e premtimit të një partie ndikon në shanset e saj për t'u rizgjedhur, pasi idetë e prezantuara me elementin e argumentit logjik dhe atë politiko-ekonomik mundëson një përkrahje më të madhe nga votuesit. Në rastin, kur qeverisja është drejtuar nga vetëm një parti politike, ajo mbetet përgjegjëse në përputhje me konsequencën e politikave të zbatuara edhe nga qeverisja më parë në fusha të ndryshme të jetës së vendit. Me këtë qasje, ajo mundet të ndikojë orientimin e votës edhe për votuesit e pavendosur, por edhe ata klientelistë duke e konsideruar se është më afër preferencave të tyre. Nga njëra anë, premtimet që bëhen në fushatë prirjen të kënaqin dëshirat personale të këtyre votuesve. Nga ana tjetër, shndërrimi i një pjese më të madhe të premtimeve në programe për zbatim në krahasim me partinë kundërshtare përbën një bazë të sigurt për një tërheqje më të madhe të votuesve të pavendosur dhe klientelistë në favor të saj.

Kjo strategji elektorale që ka përdorur me sukses Partia socialiste ka funksionuar si një largpamësi për të kënaqur pritshmëritë e votuesve për të ardhmen duke përdorur performancën e kaluar qeveritare si burimin e besueshëm të informacionit dhe argumentit.

Por, nisur nga hulumtimi i analizave, kërkimeve, si dhe diskutimeve para dhe pas zgjedhore, ne konstatojmë, se vetëm në vitet e fundit studiuesit kanë filluar të mendojnë seriozisht në drejtim të përdorimit të performancës së qeverisë si një rekord të përmbushjes së premtimeve të bëra nga partitë në programet e tyre zgjedhore.

Sigurisht, politikanët kanë qenë të interesuar më parë në dimensionet premtuese të lidhura me përgjegjësinë politike ndaj votuesve, por nuk mund të themi se kanë qenë të interesuar të nxitin një temë të tillë për analiza dhe debate të zgjeruara. Nga hulumtimi jonë mbi këtë temë na rezulton se diskutimet dhe studimet janë fokusuar më së shumti drejt diskutimit relativ mbi temat e programit zgjedhor të partive kryesore, si dhe transparencës së shpenzimeve dhe përdorimit të buxhetit dhe burimeve buxhetore/ publike të partisë në qeverisje.

Premtimet zgjedhore nuk janë bërë ende edhe sot një objekt i plotë analize dhe debati për ti konsideruar mirëfilli, si angazhime themeltare në programet e partive për të kryer politika të caktuara dhe për të arritur qëllime të caktuara. Kështu, analiza dhe diskutimi mbi premtimet zgjedhore, në zgjedhjet politike të 25 Prillit 2021 u përqendrua në pjesë specifike të programeve zgjedhore të një partie, por duke mos i konsideruar gjithë premtimet si angazhimet e vetme të politikës së ardhshme, ku në varësi të përmbajtjes së premtimit duhet të shoqëroheshin edhe me llogaritjen e kostos dhe burimeve të ndryshme, të tilla si legjislacioni, dekretet e ministrave ose burimet buxhetore.

Sidoqoftë, përtej këtij vlerësimi të gjerë të aftësisë së përgjithshme dhe gatishmërisë së çdo politikani dhe partie për të prezantuar premtimet e bëra, natyrshëm që debati duhej të fokusohet edhe te mbajtja/ riciklimi i premtimeve të bëra në zgjedhjet politike më parë. Votuesit duket se u mungonte informacioni dhe në këto zgjedhje nuk ishin më të informuar se në zgjedhjet e kaluara për performancat konkrete të premtimeve të partisë qeveritare, si dhe një analizë historike lidhur me cilësinë, ciklikën dhe nevojën e premtimeve konkrete dhe të realizueshme.

Nga analiza jonë për zgjedhjet e periudhës kohore 2009-2021 na prezantoi me gjetjen se perceptimet e qytetarëve pasqyrojnë performancën aktuale të premtimit. Ky konstatim është i rëndësishëm, nëse do të bëjmë lidhjen e tij me rezultatet e proceseve zgjedhore në periudhën e analizuar, duke përfshirë rolin e madh që tashmë ka në gjithë proceset politike shoqëria civile.

Aktivizimi i shoqërisë civile me një rol analize dhe ekspertize në rritje në dekadën e fundit duket se ka ndihmuar në formimin e kapitalit shoqëror dhe politik. Zbulimi i dukshëm i anomalive politike dhe sistematike, si dhe aktiviteti civil i shoqërisë civile në të vërtetë ka ulur përfshirjen elektorale dhe mbështetjen për partitë politike populiste dhe që nuk mbajnë zotimet e tyre (Partia Republikane, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut etj.). Kontributi i pjesëmarrjes civile në nivelin lokal, si dhe ekspertiza dhe advokimi i vlerave dhe problemeve të shtresave të përfaqësuara pak në forumet politike kanë qenë një arritje e dukshme në formimin e kapitalit shoqëror dhe politik. Efekti më i veçantë politik që ka formuar dhe po forcon kapitalin shoqëror është aktivizimi i aktivistëve të shoqërisë civile në nivel vendor dhe qendror duke kontribuar fuqimisht në kontaktimin dhe vënien para llogaridhënies të zyrtarëve publikë. Qytetarët që punojnë së bashku në nivelin lokal shfaqin kështu një tendencë të fortë për t'i përcjellë kërkesat e tyre qeverisë dhe për të qenë zëri që duhet të dëgjohet me forcë duke nxitur edhe nisma ligjore, si ajo e konsultimit publik, apo nisma të ngjashme, që më së shumti janë pjesë e arritjeve të forcimit të rolit të shoqërisë civile si një kontributor direkt dhe në forcim të përditshëm të rolit të tij në vendimmarrjen për vendime politike dhe me interes publik.

Në rrethanat e ambientit politik, social dhe ekonomik, në të cilin premtohet dhe zhvillohen programet politike të partive është një detyrë mjaft e vështirë për votuesit që t'u atribuojnë përgjegjësi partisë qeverisëse. Ekonomia dhe performanca e saj kanë në brendinë e proceseve fenomene shumë komplekse për tu identifikuar, sqaruar dhe prezantuar si përfshirje dhe përgjegjësi e vetëm një partie politike. Zhvillimi i ekonomisë ndërthuret nga aktorë të ndryshëm, të tillë si: kompani biznesi, grupe interesi, interesa publike, interesa të shteteve dhe bizneseve shumëkombëshe, si dhe ndikime nga tregtia ndërkufitare. Nisur nga kombinimet e ndryshme në jetën e përditshme, përgjegjësia nuk arrin dot t'i atribuohet në mënyrë të qartë njërit prej këtyre aktorëve, për ti bërë përgjegjës për një gjendje të keqe të ekonomisë. Nga këndvështrimi i votimit të premtimit retrospektiv, sidoqoftë, partitë mund të konstatohen nga votuesi si përgjegjëse për politika dhe rezultate të ndryshme. Kështu, votimi i bazuar te premtimi retrospektiv krijon një lidhje midis pritjeve që janë krijuar nga vetë premtimet e një partie dhe përmbushjes aktuale të këtyre premtimeve gjatë kohës së saj në qeveri (apo mospërmbushja e premtimeve politike, për nisma ligjore specifike gjatë kohës së një partie në opozitë).

Votuesit nuk harrojnë për premtimet e mëparshme të një partie qeverisëse dhe në rrethanat e një informimi korrekt, pa anësi politike, profesional dhe të argumentuar me fakte reagojnë ndaj përmbushjes së premtimeve në zgjedhjet vijuese. Së pari, përmbushja e premtimeve nënkupton përfitime të shpërblyera me votë për ta në zgjedhjet e ardhshme. Së dyti, partitë qeverisëse, që i përmbahen premtimeve të tyre gjatë mandatit legjislativ perceptohen si aktorë të besueshëm dhe të përgjegjshëm, dhe si pasojë votuesit do t'u besojnë atyre edhe në të ardhmen, si kompetentë në qeverisjen e vendit. Një argument të tillë, Partia Socialiste e përdor dhe shfrytëzon në fushatat

zgjedhore me efektivitet në kërkesën për tu votuar për vijimësi të qeverisjes së vendit. Rezultatet e analizës krahasuese na tregojnë me të vërtetë se përmbushja e zotimit të një partie qeveritare ndikon në rezultatin e saj zgjedhor.

Kështu, duket se partitë qeveritare përkeqësojnë mundësinë e tyre për t'u rizgjedhur nëse nuk i përmbahen asaj që u premtuan votuesve të tyre gjatë fushatës së mëparshme zgjedhore. Sidoqoftë, interesant dhe në kontrast me këtë gjetje duket se votimi për partinë ka më shumë gjasa të jetë në mbështetje të saj, kur ajo arrin të përcjellë qartësisht dhe me fakte përgjegjësinë e lartë të mospërmbushjes së premtimeve nga partia qeverisëse, si dhe korrupsionin e lartë që në fakt duhet të jetë kauza kryesore për të mbledhur dhe artikuluar direkt për votuesin e pavendosur.


Mungesa e publikimit të premtimeve zgjedhore në të paktën zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, 2013 dhe 2017 duket se janë taktika elektorale të partive për të mundësuar shmangien e llogaridhënies për mbajtjen e tyre. Me avancimin e informimit online dhe një shpërndarje të burimeve të informacionit në shumë individë, tashmë kjo taktikë e humbi rëndësinë dhe në zgjedhjet e vitit 2021 u përpoqën të kujdesen që të kenë një paketë premtimesh/ plan veprimi më të plotë. Por, duket se kjo qasje ishte tashmë e detyruar si një meritë e teknologjisë, medias shqiptare, si dhe grupit të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave jo qeveritare për të bërë më shumë analizë, por edhe transparencë lidhur me përgjegjësinë për premtimet partiake, por edhe programet qeverisëse bazuar mbi premtimet e partisë fituese në zgjedhje.

Ndryshimi në nivelin e votës është një matje e vendosur në literaturën ekonomike të votimit. Fitimet ose humbjet në detyrë llogariten duke zbritur përqindjen e votave të vlefshme të fituara nga secila parti qeveritare në zgjedhjet aktuale me përqindjen në ato të mëparshmet. Kështu, partitë qeveritare të konsideruara në këtë studim pësojnë një humbje të aksioneve prej 5 përqind të votave mesatarisht.

Ashtu si edhe në sistemet demokratikë të shteteve të rajonit ballkanik, të ngjashëm me sistemet pluraliste në vendet e tjera në zhvillim, politika shqiptare në dy proceset e zgjedhjeve politike më të fundit (2017 dhe 2021) është karakterizuar nga politika klienteliste⁸. Synimi i fushatës për të pasur pak ose aspak përmbajtje të politikave ka ndryshuar modelin e fushatave zgjedhore të kaluara, duke i orientuar partitë më shumë me frymën që përçon udhëheqësi/t e saj se sa me prezantime platformash dhe programesh të modeleve që jemi njohur deri pak vite më parë. Edhe premtimet e politikave dhe veprimeve që deklarohen për mandatin qeverisës në tentativë duken që janë në funksion të modelit klientelist, se sa objektive politike. Një fakt që e provon këtë është mospërfshirja e një sasive jo të pandjeshme të premtimeve të fushatës zgjedhore në programin politik qeverisës.

⁸ Klientelizmi është shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve me mbështetje politike, shpesh duke përfshirë një model të qartë shkëmbimi "një favor për një favor". Klientelizmi përfshin një marrëdhënie asimetrike midis grupeve të aktorëve politikë të përshkruar si shitës, ndërmjetës dhe klientë.

Përfshirja e premtimeve në programet qeverisëse, 2009-2021



Por më e dukshme politika klienteliste shfaqet edhe në vijimësinë e fenomenit të blerjes së të drejtës së votës. Blerja e votave është e përhapur⁹ dhe e pranuar gjerësisht¹⁰, dhe çmimi për votim zakonisht varion nga 10 mijë Lekë deri në 37 mijë Lekë për familje¹¹, megjithëse këto akuza të opozitës janë të vështira për tu provuar nga drejtësia. Çmimi ndryshon me kushtet ekonomike lokale dhe konkurrencën e zgjedhjeve dhe çfarë përmendim më lart janë referenca nga media investigative¹², bashkë me deklaratat publike të lidërshiptit politik. Këto janë shuma të konsiderueshme, duke pasur parasysh se pragu i varfërisë në 2015 nuk e kalon 500 Lekë në ditë për një familje¹³.

Edhe pse këto çmime janë jashtë normës ligjore dhe morale duke shërbyer si një faktor anormal në procesin parazgjedhor, blerja e votës është ende një strategji relativisht me kosto efikase, përderisa vijueshmëria arrin të sfidojë ligjin për pjesën e krimit zgjedhor me gjithë ashpërsimin e tij në dënimin e këtij fenomeni kriminal. Për më tepër, blerja e votës dhe nivelet e sfidimit të ligjit janë të ndërlydhura pozitivisht, duke përdorur mundësinë e mungesës së fakteve që mund të provojnë kryerjen direkte të krimit të blerjes së votës. Hendeku midis mangësive në informacionin e plotë dhe bazuar mbi prova dhe analiza, si dhe strategjitë elektorale klienteliste nxjerrin në pah një arsyetim të vlefshëm për mungesën e përmbajtjes referuese të politikës në ndryshimet e Kodit zgjedhor në këto zgjedhje. Mungesa e angazhimit në ligjërimin programor dhe mungesa e shpërndarjes së informacionit vijoi të jetë një praktikë jo pozitive në fushatat parazgjedhore dhe gjatë procesit zyrtar të tyre .

⁹ <https://www.reporter.al/transformimi-i-ps-ne-makineri-elektorale-i-jep-edi-rames-mandatin-e-trete/>

¹⁰ <https://euronews.al/al/vendi/politike/2021/04/19/soreca-nga-elbasani-te-shqetesuar-per-blerjen-e-votes-por-edhe-shitja-perben-veper-penale/>

<https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-per-median-e-ambasadores-yuri-kim/>

¹¹ <http://www.panorama.com.al/vota-shkoi-deri-300-euro-basha-ne-shkoder-dora-e-rames-qe-shtrihet-per-bashkepunim-e-mbushur-me-helm-jo-ja-ime-eshte-finale/>

¹² <https://top-channel.tv/2021/04/28/denoncimi-fiks-fare-skema-e-shitjes-se-votes-1-vote-100-mije-leke-qytetaret-japin-id-ne-kundrejt-parave-te-tjeret-votojne-per-ta/>

¹³ <https://pubdocs.worldbank.org/en/253301590709924620/RER-note-WeBa-poverty-impacts-Covid19-20May2020-2-ALB.pdf>

Mbyllje

Hulumtimi jonë mbi votimin retrospektiv¹⁴, nisur nga shembujt nga ballafaqimi i fakteve më lart na tregon se votuesit shqiptarë e konsiderojnë pak sjelljen e kaluar të partive dhe politikanëve në vendimet e tyre të votimit. Në këtë gjetje, ne konstatojmë se kjo ndikohet në tërësi edhe nga niveli i pjesëmarrjes në votime, si dhe lidhet me kategorinë e votuesit që është më masiv në ditën e votimit.

Në vazhdim të këtij argumenti, duket se zgjedhjet janë instrumente përmes të cilave votuesit shpërblejnë me votë performancën më të mirë ekonomike, por jo vetëm, pasi një pjesë e votuesve të pavendosur ndikohen në vendimet e tyre të votimit edhe nga fusha të tjera të politikave përtej ekonomisë, të tilla si: çështje të interesit kombëtar (p.sh. kufijtë detarë, emigrantët etj.). Nga ana tjetër, kategoria e votuesve ideologjikë ndikon në rezultatin zgjedhor duke shtuar votat për partinë e tyre. Edhe kategoria e votuesve klientelistë u vërejt se janë lehtësisht të ndikueshëm nga propozimet specifike të ofruara në fushatën zgjedhore, të tilla si: premtimet apo veprimet nga partia në qeverisje (përrjashtimet dhe lehtësitë tatimore, ndërtimi/ përmirësimi i infrastrukturës), premtimet nga partia në opozitë (premtimet për rritjen e pagës minimale, për punësimin, për uljen e normave tatimore, për fonde të mëdha buxhetore në edukim, bujqësi dhe shëndetësi)¹⁵.

Në dekadën e fundit, shoqëria civile është ringjallur si një variabël kryesor për të shpjeguar gjallërimin politik dhe ekonomik. Megjithatë, shoqëria civile mbetet ende një koncept i gjerë për të pasur një ndikim të vërtetë analitik. Nga njëra anë, e fokusuar më së shumti në aspektin e qasjes asistuese, por ende pa kurajon e mjaftueshme për të qenë një faktor në ndihmë direkte në konkurrencën elektorale anëtarët e organizuar të shoqërisë civile ende nuk janë pjesë e paketës si në çdo shoqëri "të fortë", domethënë, një shoqëri me nivele të larta të kapitalit shoqëror dhe qytetarë të angazhuar më fort në çështjet e vendimmarrjes dhe performimit të qeverisjes.

Për të arritur një rritje të kapitalit shoqëror duhet të kalohet në një nivel tjetër veprimi përtej thjesht informimit të qytetarëve. Koordinimi i zërit qytetar përmes krijimit të një komuniteti për të zgjeruar dhe forcuar rrjetin e një ndihme të synuar drejt qytetarit për ti asistuar ata me analizën e fokusuar deri në nivele shtruese vlen për një kuptim shumë më të mirë se deri më sot të sjelljes dhe premtimeve të politikës ndaj qytetarit.

Nga ana tjetër, kjo do të thotë shumë për hapat e ardhëm që duhen të hedhë shoqëria civile, me synimin që qytetarët të jenë mjaft të informuar, por edhe aktivë për t'i mbajtur politikanët përgjegjës për veprimet e tyre. Forcimi i kapitalit shoqëror nuk është veçse një mënyrë e ndryshme për t'iu referuar përgjegjësisë politike. Një shoqëri e fortë civile mund të jetë modeli më konkurrues i qeverisjes përmes mënyrave të tjera, të tilla si: arritja e niveleve të larta të besimit ndërpersonal dhe të cilat arrijnë të përsosen si modele të ndërveprimit shoqëror, me burokratët dhe politikëbërësit për të bashkëpunuar dhe monitoruar lehtësisht njëri-tjetrin në punën e tyre;

¹⁴ Votimi retrospektiv i referohet votimit të bërë pas marrjes në konsideratë të faktorëve të tillë, si: performanca e një partie politike në qeverisje duke supozuar se njerëzit janë më të shqetësuar për rezultatet e politikave sesa për instrumentet politikë.

¹⁵ Shih premtimet analitike në <https://polifakt.al/publikime/trajtime/>

forcimi i kapitalit shoqëror duke ushqyer virtytin qytetar në mesin e qytetarëve, i cili më pas çon në një qeverisje më të mirë brenda një komuniteti që i përmbahet rregullave që i ka miratuar vetë.

Në mënyrë që të kemi politikanë të besueshëm dhe efikas për interesin publik nevojitet domosdoshmërisht prania e një elektorati politikisht aktiv, të mirë informuar, të sofistikuar dhe me kurajon qytetare bazuar te ekspertiza dhe e vërteta.

Kontrolli politik i funksioneve publike rezulton të varet nga dy faktorë kyç. *Së pari*, zgjedhjet e lira dhe të rregullta u lejojnë qytetarëve të disiplinojnë politikanët duke patur parasysh kërcënimin e besueshëm të humbjes së qeverisjes në periudhën e ardhshme nëse politikanët nuk ju janë përgjigjur interesave të votuesve në një masë të konsiderueshme sipas informacionit që ata disponojnë. *Së dyti* dhe po aq e rëndësishme, shkalla e informacionit të qytetarëve frenon mundësitë që politikanët të përfshihen në korrupsion dhe keqmenaxhim politik. Performanca qeveritare përmirësohet pasi qytetarët kanë njohuri më precize si për politikën e miratuar nga politikanët, por po ashtu edhe për mjedisin në të cilin zbatohen, me kushtin që zgjedhjet të jenë konkurruese dhe me parametrat që nevojiten për të ndëshkuar partinë që nuk ka përmbushur premtimet. Siç tregohet në këtë parashtrim, prania e elektoratit të mirë informuar është një tregues që mundet të ndëshkojë me votë mospërputhjet e performancës qeveritare të dobët dhe jo në pajtueshmëri me zotimet elektorale dhe pranisë së shtuar të korrupsionit.

Një elektorat i mirë informuar dhe i mobilizuar politikisht ka më shumë rëndësi se niveli i zhvillimit ekonomik për të siguruar një qeverisje të mirë.

ANEKS

Performanca buxhetore, ekonomike dhe sociale e premtimeve dhe programeve politike, 2009 -2017

Qeveria 2009-2013 – Premtimet	Realizimet buxhetore, ekonomike e sociale
Premtimet per punesimin – 160 mije	Gjithsej 49 mije punesime shtese
Premtimet per mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale – 8 mld.	Gjithsej buxheti shtese 5.7 mld.Leke
Premtimet per bujqesine – 35 mld.	Gjithsej buxheti shtese 3.5 mld.Leke
Nuk do ketë pension në fshatra nën 100 dollarë	Masa e pensionit ne fshatra 80 US.D
Premtimet per pensionet – 14.7 mld. leke	Gjithsej buxheti shtese 7.4 mld.Leke
Investimet e huaja dhe ekonomia – 2.8 mld. Euro	Gjithsej kontributi buxhetor 4 mld.Leke
Heqje/ulje taksash dhe kontribute	Rezultati te ardhura 30 mld. Leke
Premtimet per arsimin – 30 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 8.6 mld.Leke
Premtimet per infrastrukturen rrugore – 140 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 180 mld.Leke
Premtimet per energjine, UK – 20 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 1.5 mld.Leke

Qeveria 2013-2017 – Premtimet	Realizimet buxhetore, ekonomike e sociale
Premtimet per punesimin – 300 mije	Gjithsej 198 mije punesime shtese
Premtimet per mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale –10 mld.	Gjithsej buxheti shtese 9.5 mld.Leke
Premtimet per bujqesine – 34 mld.	Gjithsej buxheti shtese 8.5 mld.Leke
Premtimet per pensionet – 13.5 mld. leke	Gjithsej buxheti shtese 9.5 mld.Leke
Investimet e huaja dhe ekonomia – 3.6 mld. Euro	Gjithsej kontributi buxhetor 7.5 mld.Leke
Premtimet per shendetesine – 29 mld. Leke (LSI)	Gjithsej kontributi buxhetor 5.7 mld.Leke
Heqje/ulje taksash dhe kontribute	Rezultati te ardhura 69 mld. Leke
Premtimet per arsimin – 14.5 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 1.6 mld.Leke
Premtimet per infrastrukturen rrugore – 75 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 29 mld.Leke
Premtimet per energjine, UK – 15 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 17.2 mld.Leke

Qeveria 2017-2021 – Premtimet	Realizimet buxhetore, ekonomike e sociale
Premtimet per punesimin – 220 mije	Gjithsej 89 mije punesime shtese
Premtimet per mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale –8 mld.	Gjithsej buxheti shtese 7.5 mld.Leke
Premtimet per bujqesine – 35 mld.	Gjithsej buxheti me pak 6.5 mld.Leke
Premtimet per pagat e sektorit publik – 8 mld. leke	Gjithsej buxheti shtese 4.5 mld.Leke
Investimet e huaja dhe ekonomia ≤ 3.9 mld. Euro	Gjithsej kontributi buxhetor 7.5 mld.Leke
Heqje/ulje taksash dhe kontribute	Rezultati te ardhura me 25 mld. Leke
Premtimet per arsimin – 18.5 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 24.5 mld.Leke
Premtimet per infrastrukturen rrugore – 65 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 78 mld.Leke
Premtimet per energjine, UK – 15 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 12 mld.Leke

Numri i Zgjedhësve në listë sipas qarqeve, 2009 -2021
numër

Nr.	Qarku	2009	2013	2017	2021
1	Berat	169,423	177,944	175,794	183,119
2	Dibër	122,287	129,298	127,231	131,225
3	Durrës	290,258	308,092	313,353	358,730
4	Elbasan	299,945	319,457	321,138	346,948
5	Fier	352,423	376,208	373,706	403,220
6	Gjirokastrë	121,683	123,883	122,039	123,270
7	Korçë	264,492	275,689	273,287	284,363
8	Kukës	72,942	77,968	77,072	83,027
9	Lezhë	148,491	160,189	159,207	173,899
10	Shkodër	239,578	250,144	250,803	272,078
11	Tiranë	725,446	784,484	785,086	910,494
12	Vlorë	277,978	290,899	293,169	318,428

[Burimi: kqz.gov.al](http://kqz.gov.al), instat.gov.al
Pjesëmarrja në votime PD-PS sipas qarqeve, 2009 -2021
numër

Nr.	Qarku	PD				PS			
		2009	2013	2017	2021	2009	2013	2017	2021
1	Berat	21,805	21,549	16,302	23,038	44,564	42,897	45,637	42,355
2	Dibër	34,230	30,137	21,331	29,020	21,168	25,103	24,795	28,742
3	Durrës	60,569	52,703	43,163	63,431	52,038	60,833	73,066	76,924
4	Elbasan	57,035	46,788	33,868	57,878	73,255	75,086	72,881	86,224
5	Fier	55,841	46,374	46,799	64,680	91,723	89,637	104,162	91,572
6	Gjirokastrë	18,527	13,509	13,321	14,004	29,091	25,148	27,222	24,604
7	Korçë	56,303	47,061	42,177	50,479	58,289	63,584	62,787	60,543
8	Kukës	25,596	22,426	19,935	24,071	13,692	11,385	18,387	13,856
9	Lezhë	32,400	31,605	27,550	33,998	21,992	26,433	30,406	27,269
10	Shkodër	56,515	31,605	40,763	47,205	40,964	26,433	39,247	30,296
11	Tiranë	161,332	151,472	128,065	182,335	162,757	198,834	200,517	226,842
12	Vlorë	30,310	10,552	23,207	32,128	47,284	56,481	65,684	59,023

[Burimi: kqz.gov.al](http://kqz.gov.al)

Referenca

Bowles Jeremy, Horacio Larreguy, and Shelley Liu, "Exploiting Weakness in Electoral Administration: Monitoring Brokers in a Developing Democracy," 2017

Canare Tristan A. Ronald, U. Mendoza, and Mario Antonio Lopez, "An empirical analysis of vote buying among the poor: Evidence from elections in the Philippines," South East Asia Research, 2018

Cesi Cruz, Philip Keefer, Julien Labonne, Francesco Trebbi "Making policies matter: Voter responses to campaign promises", June 2019

Elinder Mikael, Henrik Jordahl, and Panu Poutvaara, "Promises, Policies, and Pocket-book Voting," European Economic Review, 2015

Finan Frederico and Laura Schechter, "Vote Buying and Reciprocity," Econometrica, 2012

<https://ejpr.onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/1475-6765.12377>

<https://users.monash.edu.au/~nfelt/papers/vote.pdf>

<http://www.iae.csic.es/investigadorsMaterial/a9167111438archivoPdf67375.pdf>

Philip Keefer, and Julien Labonne, "Buying Informed Voters: New Effects of Information on Voters and Candidates," 2018

REAGIMI QYTETAR NDAJ PREMTIMEVE ELEKTORALE DHE PROGRAMEVE QEVERISËSE

CITIZEN RESPONSE
TO ELECTORAL
PROMISES
AND POLITICAL
PROGRAMS

